

Nr. 1 serise **21**
KOD RAPORTIMI

Nr. _____ Datë _____

**POLICË PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM
TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE
PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA**



SIGURUESI

Dega / Agjensia

Telefon/E-mail

--	--	--

I SIGURUARI / PËRDORUESIT

Pronësia:	Nipti / Numri Personal:	Adresa / Tel	E-mail		
Përdoruesit:	Gjinia	Datëlindja	Dëshmi Aftësie	Adresa / Tel/E-mail:	

MJETI MOTORIK

Targa	Kategoria	Klasa	Marka	Modeli	Ngjyra
Viti i prodhimit	Numri i shasisë	Numri i vendeve	Kapaciteti mbartës	Fuqia motorike	

PERIUDHA E SIGURIMIT

Fillon në orën : 24.00

deri në

Përfundon në orën : 24.00

PRIMI I SIGURIMIT

	Vlera në %	Vlefë pa TVSH	TVSH	TOTALI
Primi i Shkruar	-			
** Taksa mbi primin	10%			
TOTALI				

Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24 të ditës së fillimit të periudhës së sigurimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës së fundit të periudhës së sigurimit. Kjo policë sigurimi është lëshuar mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi, si dhe akteve të tjera nënligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta. (Ligji nr. 32/2021, datë 16.03.2021).

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë sigurimi i përkasin shoqërisë së sigurimit, logon e së cilës përmban kjo kontratë e regjistruar pranë AMF. Përdorimi i kësaj police si faturë tatimore është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Unë i siguruari jam dakord me kushtet e përgjithshme dhe përjashtimet e shprehura në faqen e pasme të policës.

I SIGURUARI

AGJENTI

LËSHUAR NË PËRGJEGJËSINË E:

(Emër/Mblemër/Firmë)

(Emër/Mblemër/Firmë)

*Ligji nr. 9572 dt. 03.07.2006 "PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE", (i ndryshuar), Neni 27.

**Ligji nr. 9975 dt. 29.07.2008 "PËR TAKSAT KOMBËTARE", (i ndryshuar), Neni 5.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekti i kësaj kontrate është sigurimi i përgjegjësive të drejtuesit të mjetit motorik për dëmet që ky drejtues mund t'i shkaktojë palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij me faj, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Kjo kontratë sigurimi është me afat 1-vjeçar dhe mbulon përgjegjësinë e të siguruarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Nuk zbatim të ligjit 32/2021 dhe brenda kufijve të përcaktuar, kjo kontratë mbulon dëmin ndaj pronës dhe dëmin ndaj personit, i cili llogaritet sipas Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të dalë në zbatim të nenit 11 të këtij ligji. Dëmi ndaj pronës është dëmi i pësuar si rezultat i dëmtimit apo shkatërrimit të pronës, ndërsa dëmi ndaj personit është dëmi që vjen si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore dhe përqekësimeve të shëndetit që pëson pala e dëmtuar ose të afërmit e tij. Këtu përfshihet dëmi pasuror dhe jopasuror. Sendet dhe objektet e përdorimit të zakonshëm, të cilat për vetë natyrën e tyre mbahen me vete nga personat që transportohen, janë objekt i kësaj kontrate.
2. Sigurimi i përgjegjësive të mbajtësve të mjeteve motorike nuk mbulon dëmet e sendeve, të cilat i ka marrë përsipër t'i transportojë mbajtësi i mjetit, shkaktar i aksidentit dhe që ndodhen në mjet në çastin e ndodhjes së aksidentit.
3. Përgjegjësia e pronarit të mjetit motorik zbatohet për dëmet e shkaktuara si nga mjeti tërheqës, edhe nga mjeti i tërhequr.
4. Kontrata e sigurimit mbulon edhe dëmet ndaj personit dhe pronës që mund t'u shkaktohen këmbësorëve, çiklistëve, si dhe përdoruesve të mjeteve jomotorike që lëvizin në rrugë.
5. Shoqëria e sigurimit është e detyruar që së bashku me policën e sigurimit t'i dorëzojë të siguruarit Raportin Europian të Aksidenteve sipas formularit të miratuar nga Autoriteti.
6. Në të gjitha ato raste kur mjeti motorik i jepet në përdorim një personi, emri i të cilit nuk është shënuar në policën e sigurimit, pronari i mjetit duhet të njoftojë shoqërinë e sigurimit që ka lëshuar policën, e cila llogarit tarifimin përkatës për sigurim, në rastet e aplikimit të sistemit bonus-malus.
7. Të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, kur ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, i kalojnë pronarit të ri dhe vlejné deri në përfundimin e kontratës së sigurimit. Pronari i ri, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, detyrohet të njoftojë shoqërinë e sigurimit për ndryshimin e pronës së mjetit dhe pasqyrimin e këtij ndryshimi në kontratën e sigurimit.
8. Afati i parashkrimit të palës të tretë të dëmtuar, për kërkimin e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit, është 2 vjet nga dita e ndodhjes të aksidentit në bazë të nenit 115, shkronja ç) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

PËRJASHTIMET NGA MBULIMI NË SIGURIM DHE PËRJASHTIMI NGA DËMSPËRBLIMI

9. Nuk përfiton nga kjo kontratë sigurimi:
 - a) drejtuesi i mjetit, shkaktar i aksidentit, përfshirë këtu trashëgimtarët e tij ligjorë dhe të afërmit e tij, për dëme që i shkaktohen këtij drejtuesi;
 - b) çdo bashkudhëtar që ndodhet me vullnetin e tij në mjetin motorik shkaktar të aksidentit, të drejtuar nga një drejtues i paautorizuar, kur provohet se personi që ndodhet në mjet ishte në dijeni të këtyre rrethanave;
 - c) çdo bashkudhëtar që ndodhet me vullnetin e tij në një mjet të pasiguruar, shkaktar të aksidentit, kur provohet se personi ishte në dijeni të kësaj rrethane;
 - d) personi, i cili ka përvetësuar mjetin motorik në mënyrë të kundërligjshme dhe është dëmtuar gjatë përdorimit të këtij mjeti;
 - e) personi i dëmtuar në këto raste:
 - i) për shkak të përdorimit të një mjeti në ngjarje sportive në rrugë apo pjesë rrugësh, të palejuara për drejtim të mjetit, për arritjen e shpejtësisë mesatarisht të larta ose për t'u stërvitur për gara;
 - ii) për shkak të pasojave të energjisë bërthamore gjatë transportit të materialeve radioaktive;
 - iii) për shkak të veprimeve të luftës, reviltave ose akteve terroriste, me kusht që shoqëria e sigurimit të provojë se dëmi është shkaktuar nga ngjarje të tilla.
 - f) drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin për të cilin ai është i destinuar të përdoret;
 - g) drejtuesi nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorik, sipas kategorive apo tipit të mjetit, përveç rasteve të përdorimit gjatë mësimave të drejtimit të mjetit, kur ky drejtohet nga kandidati drejtues sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimave;
 - h) drejtuesit të mjetit motorik i është pezulluar leja e drejtimit, i është ndaluar të drejtojë tipin dhe kategorinë e mjetit ose i është ndaluar përdorimi i lejes së drejtimit, të lëshuar nga një vend tjetër për në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - i) drejtuesi drejton mjetin motorik nën ndikimin e alkoolit mbi kufirin e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psikoaktive;
 - j) drejtuesi e shkakton dëmin qëllimisht;
 - k) aksidenti ndodh për shkak të defekteve teknike të mjetit, për të cilat drejtuesi ka qenë në dijeni;
- Humbja e të drejtave që rrjedhin nga sigurimi, siç përcaktohen në shkronjat "f" deri në "k", nuk kufizon të drejtat e palëve të treta për të paraqitur kërkesën për dëmshpërblim të siguruesi përgjegjës, i cili ka të drejtë të rimburojë të gjithë masën e paguar për dëmet, interesat dhe shpenzimet nga personi përgjegjës për dëmet.

DISPOZITA TË TJERA

10. Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë Rastin e Sigurimit, menjëherë dhe sa më shpejt, pranë shoqërisë së sigurimit përgjegjëse.
11. Pala e dëmtuar i drejtohet me kërkesë për dëmshpërblim drejtpërdrejt shoqërisë së saj të sigurimit, në rastin kur shkaktari i aksidentit është i pasiguruar apo i paidentifikuar, mbi çdo dëm të shkaktuar mbi pronën apo shëndetin e tij.
12. Shoqëria e sigurimit trajton kërkesën për dëmshpërblim dhe njofton palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, për dëme ndaj personit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim dhe për dëme ndaj pronës me vlerë mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim. Pagesa pas trajtimit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit bëhet brenda 14 ditëve kalendarike. Ndërsa për dëme ndaj pronës me vlerë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, trajtimi dhe kryerja e pagesës së dëmshpërblimit, bëhet brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.
13. Në zbatim të nenit 9 dhe nenit 10, pika 10, të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", pas trajtimit dhe marrjes së përgjigjes nga shoqëria e sigurimit/Byroja, pala e dëmtuar që ka pretendime, mund t'i drejtohet gjykatës me padi civile.
14. Drejtuesit e mjeteve të përfshirë në një aksident rrugor, për dëmet ndaj pronës në vlerë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, nëse bien dakort duhet të plotësojnë, të nënshkruajnë dhe të shkëmbejnë Raportin Evropian të Aksidenteve, pa patur nevojë që të kenë procesverbalin e konstatimit të shkëljes nga Policia Rrugore. Për dëme ndaj pronës deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, vetëm në rastet kur drejtuesit e mjeteve të përfshirë në aksident nuk bien dakord, si dhe për të gjitha dëmet e pronës mbi këtë vlerë duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkëljes nga Policia Rrugore.
15. Bazuar në ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", kufiri minimal i përgjegjësive, që mbulohet nga kontrata e sigurimit me hyrjen në fuqi të ligjit përcaktohen në nenin 25, të këtij ligji. Për kontratat e lidhura nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2026, kufiri për dëmet shkaktuar nga mjetet e tjera përfshirë mjetet e paidentifikuara do të rritet me 4 000 000 (katër milionë) lekë çdo vit si dhe kufiri për çdo person të dëmtuar në një ngjarje sigurimi do të rritet me 2 000 000 (dy milionë) lekë çdo vit.
16. Të dhënat personale të mbledhura nga kjo kontratë (*emri i policës së sigurimit të detyrueshëm*) do të përdoren në administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënie e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit, përfshirë trajtimin e dëmit, në zbatim të ligjit nr. 32/2021 datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Shoqëria e sigurimit (*emri i shoqërisë*) realizon transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesit sipas specifikimeve të ligjit. Në lidhje me të dhënat personale të mbledhura dhe përpunimin e tyre, klienti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e aksesit dhe të drejtat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar).

Verifikoni policën tuaj të sigurimit TPL në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në faqen web të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare www.amf.gov.al ose duke kontaktuar në konsumatori@amf.gov.al.